



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) bazuar në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit (Nr. 03/L-223) për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë si dhe Rregullores Nr.09/2016 për Procedurat e zgjedhjes, emërimit, vlerësimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës (të ndryshuar me Rregulloren 14/2016, 17/2016 dhe 05/2017), shpall

## **KONKURS**

### **PËR KRYETAR TË GJYKATËS THEMELORE TË MITROVICËS**

#### **KRITERET DHE KUALIFIKIMET PËR KANDIDATË**

- Të drejtë aplikimi për kryetar të gjykatës kanë gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
- Kandidati për kryetar të gjykatës duhet të ketë tri (3)vite përvojë pune si gjyqtar.
- Kandidati për kryetar të gjykatës të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht nëse ndaj tij është shqiptuar masa e qortimit vetëm një herë.
- Kandidati për kryetar të gjykatës duhet të:
  - o njoh punën e administratës gjyqësore;
  - o ketë reputacion që kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë;
  - o ketë komunikim korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës;
  - o jetë i gatshëm për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera;
  - o të jetë kreativ në punë, duke lehtësuar kështu punën e gjykatës.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës merr në konsideratë trajnimet apo përvojën menaxheriale të kandidatit për kryetar të gjykatës.

## FORMULARI I APLIKACIONIT

Kandidatët për kryetar të Gjykatës mund ta shkarkojnë aplikacionin në Ueb faqen e KGJK-së.

[Shkarko Aplikacionin](#)

### KONCEPT DOKUMENTI

Bashkë me aplikacionin për kryetarë të gjykatës kandidatët paraqesin:

- Koncept dokumentin lidhur me vizionin e kandidatit për mënyrën e menaxhimit të gjykatës si dhe ngritjen e efikasitetit në bazë të resurseve ekzistuese:
  - i. për implementimin e rregulloreve, vendimeve, strategjive dhe planeve të veprimit, të aprovuara nga KGJK;
  - ii. për menaxhimin e gjykatës;
  - iii. planin për administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë në gjykatë;
  - iv. për veprimtarinë financiare, buxhetore dhe prokurim;
  - v. për personelin e gjykatës;
  - vi. për identifikimin dhe adresimin e problemeve si dhe propozimin për zgjidhjen e tyre.

**Aplikacionin bashkë me dokumentet e tjera të kërkuara dorëzohen në Sekretariatit e KGJK-së ose në EULEX Kosova, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes së pozitës së lirë.**

---

PËR MË SHUMË INFORMACIONE, JU LUTEM REFEROJUNI RREGULLORES 09/2016 PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES, EMËRIMIT, VLERËSIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS, (TË NDRYSHUAR ME RREGULLORET 14/2016, 17/2016 DHE 05/2017).